




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e dymbëdhjetë XII, e rregullt e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 06.12.2019, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Betim Ahmeti, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Aida Alimi, Arjana Zogiani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Shaban Ademi, Mehdi Lahu, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Hysni Hasani dhe Ljubisa Qirkoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Abdullah Prebreza - Drejtori i Planifikimit Urban, Nuriye Fazliu - Drejtore e Administratës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Jakup Tërnavë - Drejtor i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Afrim Krasniqi - Drejtor i Inspektoratit, Islam Shabani - Drejtor i Arsimit, Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik.

Të tjerë: Hasime Qyqalla - Përfaqësuese Juridike e Komunës dhe Hysen Sllamniku - Zyrtar për Mirëqenie Sociale.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 31.10.2019.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për fillimin e procedurave për lejimin e ndërtimit të objektit shkollorë në Fushë-Kosovë me kompensim në ndërtim.
4. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e marrëveshjes për kompensim të pronarëve në fshatin Sllatinë e Madhe.
5. Propozim për shqyrtimin e Planit Komunal për Personat e Riatdhesuar 2019-2022.
6. Propozim për caktimin e Komisioneve për përzgjedhjen e krijuesit dhe sportistëve për vitin 2019.
7. Propozim për lejimin e mjeteve financiare për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti në Shqipëri.
8. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, kërkoi që të mbahet një minutë heshtje për të nderuarë viktimat e fatëkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26 nëntor në Shqipëri. Në vazhdim u mbajtë një minutë heshtje nga të pranishmit në mbledhjen e Kuvendit të Komunës. Kryesuesja propozoi pikë shtesë për shqyrtim të jetë edhe ‘Propozimi për lejimin e mjeteve financiare për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor në Shqipëri’. Hap diskutimin.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. E nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës para votimit të rendit të ditës, neve duhet të na jepet mundësia që t’i shprehim qëndrimet tona, sepse kjo parashihet edhe me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës. Në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar të mbajtur me datës 31.10.2019, në faqën e fundit të tij, e keni pranuar që ‘Propozimi për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa’, të jetë në rendin e ditës, tani unë po e lexoi tekstualisht procesin e vendimarrjes, ky propozimi i z. Remzi Shala Shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka qenë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, mbledhjen e sotme, ky propozim është miratuar me trembëdhjetë vota ‘për’, nga gjithësej njëzet e pesë anëtarë të Kuvendit të Komunës të pranishëm në sallë, ndërsa z. Durim Hajra Shef i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ka kërkuar që ky komitet të themelohet, sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018, me përfaqësim nga partia e parë deri te partia e shtatë mbështetur në rezultatin zgjedhor. Unë kërkoi që të respektohet votimi i rendit të ditës dhe procesi i vendimarrjes në Kuvendin e Komunës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Në mbledhjen e kaluar kemi patur paqartësi, sepse me numër të votave Partia Liberale Egjiptiane është parti politike para juve me vota në Kuvendin e Komunës.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ju znj. Kryesuese duhet ta respektoni rendin e ditës, e jo të veproni sipas urdhërave të Nënkrëtarit të Komunës, sepse në këtë mënyrë po i merrni mbi vete, të këqijat e Ekzekutivit të Komunës.

Nënkrëtar i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ju i nderuari z. Migjen Kolshi, po flisni të pa vërteta publikisht dhe po më merrni për gojë, mua si Nënkrëtar i Komunës, vendimarrja është e juaja si Kuvend i Komunës.

Migjen Kolshi: Duke daluar nga mbledhja asambleistët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, ju e nderuara znj. Kryesuese duhet ta mbani qëndrimin tuaj personal. E vërteta është, ajo që e theksova unë lidhur me qëndrimet publike të shprehura në atë mbledhje.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Unë kam qëndruar në sallën e Kuvendit, si Kryesuese e Kuvendit të Komunës.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne kemi të drejtë 100%, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës ka qëndruar në sallën e Kuvendit, duhet ta pranoni se ka patur paqartësi, vendimet tona për Komitete të Përhershme janë konfirmuar si të ligjshme nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës nuk numërohet si anëtare e Komitetit për Politikë e Financa, po ashtu duhet të kemi parasysh edhe ruajtjen e kriterit gjinorë në përfaqësim minimum katër me tre. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të trajtohet në mbledhjen e ardhshme.

Driton Ademi: Është për keqardhje të vini në këtë nivel, unë shqip e lexova ekstraktin e procesverbalit, ju keni propozuar që kjo çështje të trajtohet sot, atëherë votimet në Kuvendin e Komunës, ju po i bëni për hajgare, kjo punë kështu nuk ka kuptim?.

Mehdi Lahu: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Kjo pikë e rendit të ditës nuk mund të lidhet fare me përfaqësuesin e Partisë Liberale Egjiptiane, prezencën e tij në Kuvendin e Komunës, anëtar i Kuvendit të Komunës z. Driton Ademi ka të drejtë, sot duhet të shqyrtohet 'Propozimi për themelimin e Komitetit për Politikë e Financa'.

Ali Ismaili: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Theksoi mendimin e tij se 'Kjo punë është nisur me hile dhe ka përfunduar me marre', ju Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës keni vepruar në mënyrë jo të drejtë, duke e votuar për anëtar të Komitetit për Politikë e Financa, personin e fundit në listën zgjedhore, ne e njohim personin, nuk kam asgjë personale kundër tij, por ligji dhe udhëzimet administrative e rregullojnë mënyrën e përfaqësimit në Komitetin për Politikë e Financa, me këtë veprim jo ligjor, ju i keni hyrë në hak dikujt individualisht, si dhe kolektivisht ju që e keni votuar propozimin në fjalë. Kjo punë e nisur keq, nuk mund të zgjidhet pa vullnet politikë, tani do të komentoi mbledhjen e fundit të Kuvendit të Komunës, ku Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, dega në Fushë-Kosovë, që është edhe në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës, ka deklaruar, që Lidhja Demokratike e Kosovës do ta luan rolin e saj në Komitetin për Politikë e Financa, sepse i ka 12 anëtarë në Kuvendin e Komunës dhe 40% të votive, pse të na toleron neve, kur vullneti i tyre politikë është që të shken dispoziat e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018, e kan njet që me këtë përbërje të Komieteit për Politikë e Financa ta përmbyllin mandatin, por duhet ta dini se i keni hyrë në hak njerëzve, të cilët do ta kërkojnë të drejtën e tyre, ndoshta edhe deri në zgjedhjet për Kryetarin e Komunës në vitin 2021, këtë punë do ta ngrisin edhe para qytetarëve gjatë fushatës zgjedhore, kjo mënyrë e veprimit politikë nuk është në rregull. Ju duhet ta vendosni në votim pikën e rendit të ditës, mund të shikohet edhe ingjizimi i mbledhjes, ku trembëdhjetë anëtarë kanë votuar për ta shqyrtuar këtë pikë në mbledhjen e sotme, kjo çështje është shumë e qartë, por këtu kemi të bëjmë me arrogancë të votave dhe dymbëdhjetë votat e opozitës nuk vlejné fare, nuk vlenë as ligji, as udhëzimi, as rregullorja.

Nënkrjetari i Komunës: E vërteta është se atë ditë ka patur fuqi politike në vendimarrje, por për çështjen në fjalë, ne kemi kërkuar nga ju si opozitë që t'i zgjidhni përfaqësuesit tuaj me rotacion në fillim, në mbledhjen e fundit, ka munguar përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Ashkalinjëve të Kosovës, pas kalimit të anëtarit z. Qerim Gara në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës, një vend ka mbetur i lirë, ne kemi kërkuar që përfaqësuesi i ashkalinjëve z. Hysni Hasani dhe përfaqësuesi i Nismës Socialdemokrate z. Driton Ademi, të jenë anëtarë të Komitetit për Politikë e Financa dhe ta zgjidhim këtë problem të ngritur nga ju, por ju nuk jeni pajtuar, andaj është shtyer për shqyrtim kjo pikë e rendit të ditës. Po ashtu, ne duhet ta ruajmë edhe strukturën gjinore, sepse nuk pranohet vendimi.

Ali Ismaili: Kjo punë është nisur keq, por edhe konstatimet tani po i bëni të pa drejta, duhet të respektohet Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018.

Nënkrjetari i Komunës: Ëshë punë e Kuvendit të Komunës, që ta zgjidhë këtë problem të ngritur nga ju.

Driton Ademi: Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018 thotë se përbërja e Komitetit për Politikë e Financa, sipas këtij udhëzimi duhet të zgjidhet nga Kuvendet e Komunave deri më datën 31 mars 2019, ju e keni shkelur këtë udhëzim, unë nuk e kam këtë punë personale, edhe pse e drejta është

në anën time, ne nuk e dimë cilin udhëzim ju po e prisni, udhëzimi që është në fuqi duhet të zbatohet.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Edhe unë kam qenë pjesë e diskutimit në mbledhjen e kaluar, pa dashur të përsëris qëndrimet e shprehura këtu nga Nënkryetari i Komunës dhe asambleistët z. Ali Ismaili dhe z. Driton Ademi, asambleisti z. Driton Ademi ka të drejtë kjo pikë është vendosur që të jetë pjesë e rendit të ditës.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Jemi duke humbur shumë kohë, për çështje teknike, që e tejkalojnë nivelin tonë, pa produkt, edhe juve znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, ju mbetet që të na sqaroni, disa çështje, ne nuk jemi kotë këtu njëzet e shtatë anëtarë të Kuvendit të Komunës, të defaktorizohemi pa asnjë arsye, të bisedohet kjo punë dhe të zgjidhet, me këtë udhëzim administrativ, apo ta presim udhëzimin e ri administrativ, kjo është punë shumë teknike.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Ne jemi duke e pritur Udhëzimin e ri Administrativ, që do ta definon këtë çështje, mënyrën e përfaqësimit.

Ilir Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Nuk mund ta konstatojmë ju tani këtu sa anëtarë i takojnë Lidhjes Demokratike të Kosovës, dy apo më shumë. Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e udhëheq Komitetin për Politikë e Financa, ne ju kemi ofruar mundësinë që të zgjidhni në vitin 2017, por ju nuk e keni bërë këtë, keni patur mospajtime lidhur me përfaqësimin tuaj në Komitetin për Politikë e Financa, kjo nuk është problem i yni tani.

Ali Ismaili: Pajtohem me konstatimin e asambleistit z. Naser Graiçevci, se këtë problem duhet ta zgjidhim, e jo ta diskutojmë, unë e kam dhënë qëndrimin tim, nuk dua ta përsëris prap, por Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, i ka kthyer përgjigje edhe z. Driton Ademi, ju e keni heshtur. Nuk ka nevojë të na vendosni neve në lajthitje, ta zbatoni Udhëzimin Administrativ në fuqi, nëse pëson ndryshime, ne jemi këtu që ta trajtojmë prap.

Driton Ademi: Pajtohem nëse kjo pikë trajtohet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme, duke ua dërguar Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018, të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës së propozuar me pikën shtesë 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor në Shqipëri' dhe kërkesën që pikë e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme të jetë 'Propozimi për plotësimin me anëtarë të ri i Komitetit për Politikë e Financa'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi, rendin e ditës së propozuar me pikën shtesë 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor në Shqipëri' dhe kërkesën që pikë e rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme të jetë edhe 'Propozimi për plotësimin me anëtarë të ri i Komitetit për Politikë e Financa'.

Pika e parë (1) - Arovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e datës 31.10.2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim, ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 31.10.2019, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim për diskutimet tuaja.

Remzi Shala: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk kemi asnjë vërejtje, andaj propozojmë që ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 31.10.2019, të aprovohet.

Pasi që vërejtje apo sugjerime tjera për përmbajtjen e ekstraktit të procesverbalit nuk pati nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 31.10.2019.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 31.10.2019.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrojnë pyetjet e tyre për Ekzekutivin e Komunës.

Ali Ismaili: Unë e kam një pyetje, për Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me defektet dhe pamundësinë e marrjes së shërbimeve të EKG, rentgenit, në kuptim edhe të pulmologjisë, sëmundjes së mushkërive në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, e cila nuk mund të kryhet për tre muaj rreshtë, ne i kemi mbi 50.000 mijë banorë, që nuk mund t'i marrin këto shërbime, e dyta analiza e hemogramit, kryhet vetëm paradite, të nderuarë njerëzit sëmuren edhe pasdite, andaj unë kërkoi që ky shërbim të ofrohet për pacientët edhe në ndërrimin e pasdites, nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, e kërkoi një sqarim për këtë punë.

Durim Hajra: Unë tani këtu i drejtohem Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, problemet me ndriçimin publik në lagjen 'Dardania', po vazhdojnë, po ashtu kërkojmë që të vendoset ndriçimi publik një llampë, edhe tek nënkalimi, nënurën e fshatit Miradi e Poshtme, sepse qytetarët kanë vështësi për kalimin e rrugës.

Sabit Bullatovci: Kjo është e habitshme, të kërkohet rregullimi i çështjeve në fshatin Miradi e Poshtme, nga ju, unë i kam kërkuar të zgjidhen të gjitha për fshatin tim. Kjo punë nuk funksionon kështu i nderuari z. Durim Hajra.

Durim Hajra: Respekt për moshën, por unë këtu i ngris, problemet e qytetarëve nëpër të gjithë territorin e komunës, pastaj në fshatin Henc, ka probleme me ujërat e zeza, unë i kam këtu edhe fotografitë, por nuk dua t'iu lodh juve si anëtarë të Kuvendit të Komunës, këto janë problem që po përsëriten kohë pas kohe në këtë fshat.

Remzi Shala: Realiteti është ashtu, e vërteta qëndron, por këtë punë nuk kemi mundur ta rregullojmë as me 'paty cash', shuma është afër 2,000.00€, është hapur tenderi, është anuluar, nuk ka konkurruar askush. Kryerja e analizave të hemogramit pasdite, nuk është bërë deri tani për arsye se na mungon stafi shëndetësorë, por duhet ta analizojmë si mundësi që shërbimet shëndetësore t'iu ofrohen pacientëve edhe në ndërrimin e pasdites.

Migjen Kolshi: Ndriçimi publik në fshatin Harilaç nuk ka funksionuar për pesë ditë reshtë, pyes, cila është zgjidhja ndriçimi solar që ka dështuar, apo tani duhet të orientohemi vetëm të ndriçimi publik përmes energjisë elektrike. Është mirë të jeni, punëkryes në Komunën e Fushë-Kosovës, sepse askush nuk të mbikëqyrë gjatë kryerjes së punëve publike. Pyes, tenderi për mbjelljen e

blinave, ndërsa aty janë mbjellur molla të egëra, madje jo nga punëkryesi, por nga punëtorët fizik të komunës. Pyes, a duhet të mbillen këto pemë nga Kompania që e ka fituar tenderin, apo nga komuna?.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pyes, pse nuk po funksionon Komisioni për emërtimin e rrugëve, sepse unë po kam nga dy-tre telefonata në ditë, lidhur me këtë punë. Tërmeti tragjik i ndodhur me datën 26 nëntor në Shqipëri, është ndierë bukur shumë edhe në Komunën e Fushë-Kosovës, pyes zyrtarët e Drejtorisë së Inspektoratit, a kanë dalur në terren për të evidentuar ndonjë dëm eventual. Na është thënë se qëndrueshmëria e objekteve kolektive në Fushë-Kosovë është deri në 7.2 të shkallës së Rihterit, por edhe me 3 shkallë janë vërejtur dëmet, kjo është skandaloze, janë qarë disa mure, tërmeti ka qenë i tmerrshëm.

Nënkryetari i Komunës: Kërkesat duhet të adresohen në komunë, i kemi patur dy raste nga tërmeti, por pa kërkesa të theksuara për dëme, nëse kemi kërkesa ato vlerësohen nga një Komision Vlerësues.

Mehdi Lahu: Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, a duhet që trotuaret e Komunës së Fushë-Kosovës të inspektohen, ta kemi një partneritet publiko-privat, sepse tani për tani ka shumë problem në terren. Shembullin konkret e kemi në rrugën 'Shkurie Obërtinca' në Fushë-Kosovë, ku Kompania e ndërtimit 'Model Sllovenia' nuk i riparoi rrugët pas përfundimit të punës së saj, njësoi vepron prap 'Model Sllovenia' në rrugën 'Nëna Terezë' nuk e bënë sanimin e dëmeve. Po ashtu, kemi probleme të njëjta me Kompaninë e Ujësjetës Rajonal 'Prishtina', e cila nuk i sanon dëmet që bënë në rrugët tona, kjo punë nuk duhet të funksionon kështu në vazhdimësi, duhet të kemi një kontroll më të madhe. Komuna e Fushë-Kosovës ka një territor të vogël dhe shumë lehtë mund të menaxhohet, e jo të veprojnë të tjerët si të duan. E kam një pyetje tjetër, për Drejtorinë e Drejtorisë së Planifikimit Urban ose Nënkryetarin e Komunës, kur do ta kemi Hartën Zonale të Komunës, në mënyrë që të heqin dilemat për kushtet e ndërtimit, ato të jenë të qarta për të gjithë territorin e komunës?.

Drejtori për Planifikim Urban: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Projektin për hartimin e Hartës Zonale të Komunës e kemi filluar në muajin prill të vitit 2017, pas aprovimit në parim të saj në fillim të këtij viti, kanë qenë disa mosmarrëveshje të pakuptimta dhe të pa qarta për ne, tani ato janë sqaruar, Harta Zonale e Komunës është pranuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe muajin e ardhshëm, do ta keni për shqyrtim dhe miratim përfundimtarë.

Mirvete Gërguri: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Lidhur me tenderin e përsëritur në shëndetësi për roentgen, duhet të shikohet qartë, cilat janë arsytet për anulimin e tij, të ndahen mjetet financiare të mjaftueshme, prodhuesi, specifikimi teknik, kushtet e tregut, të shikohen të gjitha të bëhen në mënyrën e përshtatshme dhe eliminohen pengesat e panevojshme dhe pacientët në këtë rast të mos i vuajnë pasojat. E dyta kopshtet e fëmijëve, q-erdhet, duhet të bëhen me standarde, fëmijet e kanë qasjen direkt në asfalt, të shikohet mbrojtja e fëmijeve, të punohet me standarde, e jo vetëm të shikohet ana e interesit të bizneseve.

Remzi Shala: Këtu nuk është problemi të mbikëqyrja, specifikimi teknik ka qenë i saktë, por prapë ka dështuar tenderi.

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Disa pyetje që unë deshta t'i parashtroi vetëm se u ngritën për diskutim nga anëtarët i Kuvendit të Komunës z. Mehdi Lahu, unë tani, pyes, a kanë të drejtë të bëjnë përmirësimin teknik të objekteve?, punëtorët e punësuar përmes projektit të Karitasit, duke i anashkaluar kuadrat profesional me shumë vite përvojës së punës. Këta punëtorë kanë kontrata të përkohshme. Ne nuk kemi nevojë që përgjigjet për shëndetësi të na jepen nga

Doktori z. Remzi Shala i cili e mban edhe pozitën e Shefit atje, ndoshta puna e tij është e ndërlikuar, por ne kërkojmë përgjigje zyrtare nga Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, sepse përgjegjëjet e tij, ne mund t'i konsiderojmë edhe si të njëanshme. Në shëndetësi ka probleme serioze, infuzionet duhet të blihen në barnatore, ato janë të lira 1.80€, por nuk është mirë që me muaj të tërë të mos mund të merren shërbime shëndetësore, analizat e hemogramit të mos bëhen edhe në ndërrimin e pasditës. Nuk pajtohem as me ndërhyrjen nga vendi të anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Sabit Bullatovci, sepse ne kemi marrur vota në gjithë territorin e komunës dhe jemi përgjegjës për të mbrojtur interesat e qytetarëve në secilin fshat. Edhe lidhur me fshatin Henc qëndron problem që u paraqitë këtu, ne jemi katër përfaqësues, por shpeshherë nuk i paraqesim drejtë problemet për lloj lloj arsye, anëtari i Kuvendit të Komunës z. Durim Hajra ka plotësisht të drejtë dhe unë e falënderoi për ngritjen e këtij problemi.

Remzi Shala: E vërteta është se analiza e hemogramit nuk mund të bëhet tani për tani, se aparatura është e prishur, furnizimi me barna nga lista esenciale varet nga Ministria e Shëndetësisë.

Drejtori për Planifikim Urban: Sqaroj se, pranimin teknik të objekteve e bëjnë Inspektorët e Ndërtimit, ndërsa pranimin teknik të projekteve publike, e bëjnë edhe punëtorët e Karitasit dhe për këtë punë duhet të pyetet, Drejtoria e Administratës dhe Zyra e Personelit.

Naser Graiçevci: Pyes, a ka çerdhe me partneritet publiko-privat, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës?. Cili është statusi juridik i funksioimit të Çerdhes së Fëmijëve në fshatin Miradi e Poshtme?. I nderuari, Drejtor i Shërbimeve Publike z. Maliq Berisha, rrugët në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës janë në gjendje katastrofale, të dëmtuara në çdo vend, vendosen pengesa në rrugë pa asnjë paralajmërim, ne pajtohem se në ndonjë rrugë ka punime, nevoja për ndërtuesit, por ato të jenë me një shenjë paralajmëruese, se kjo punë është e lejuar nga komuna dhe zgjat për kohën e caktuar. Pengesat në rrugë ndikojnë në acarimin e gjendjes në trafik, amortizimin e makinave, humbjen e kohës për njerëzit, unë ju drejtova juve, por kjo punë, ndoshta duhet të rregullohet në mënyrë të kombinuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Drejtoria e Inspektoratit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike e Mjedisit, duhet të funksionon ligji. Unë i kuptoi interesat e bizneseve, por interesat e qytetarëve duhet të vendosen në rendin e parë.

Doruntina Jashari: Përshendes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, pse nuk po merrni pjesë në seminarët që organizohen nga Organizata të ndryshme, ku janë prezentë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe si drejtor t'i paraqitni para tyre problemet dhe specifikat e Komunës së Fushë-Kosovës lidhur me numrin e punëtorëve, pamundësinë e vazhdimin të shërbimeve në pediatria dhe gjinekologji, ku nuk pranohen ndryshimet, nga Ministria e Shëndetësisë e cila po e neglizhon çështjen e Komunës së Fushë-Kosovës.

Sabit Bullatovci: Përshendetje për të gjithë, unë i kërkoi falje anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Durim Hajra. Unë kam punuar për tridhjetë vite, për të arritur disa qëllime të caktuara në fshatin tim, nënkalimi te lumi 'Sitnica' është nënujë, te ura është rrezik të vendosen paisjet e rrymës elektrike, ne duhet të jemi në pozicione të njëjta për ta evidentura të këqijat. I kam edhe disa kërkesa për Ekzekutivin e Komunës, në rrugën e asfaltuar nga fshati Vragoli në drejtim të fshatit Batusë, kalojnë kamionë të mbushur me tonelata të sterileve pa asnjë kriter, pyes kush e ka lejuar Kompaninë 'Al Trade' të ndërtoj objektin atje, kjo punë nuk është trajtuar në Kuvendin e Komunës. Furra e bukës është hapur në pronën publike, prona ku është hapur furra, na takon neve të gjithë fshatarëve. Çerdhja e Fëmijëve në fshatin Miradi e Poshtme funksionon, unë dy muaj kam punuar vetë nga një orë në ditë, i kam shpërndarë dymbëdhjetë kamiona me dhe, aty janë fëmijët,

duhet të punojmë për të mirën e tyre. Unë vetë i kam mbjellur njëqind drunjë dekorativ në fshatin tim. Kërkoj ngaju të rinjët që të inkuadroheni në Fushë-Kosovë, të punoni e jo vetëm të flisni, së bashku t'i gjejmë gabimet tona dhe t'i zgjidhim problemet. Unë për dhjetë vite e kam kërkuar mbikalimin, por nuk lejojnë të veprohet Ministria e Transportit, asnjë i ri sot nuk po punon sa duhet, i nderuari z. Ali Ismaili, të këqijat duhet t'i largojmë së bashku.

Ali Ismaili: Ne kemi bërë shumë pyetje, kemi vënë në pah shumë dukuri që të punojnë Drejtoritë e Komunës. Në rrugën 'Imer Svarqa' mungon ndriçimi publik, aty ka shumë qen endacakë, nuk është asnjë dritë aty. Asfaltimet të shkolla 'Mihal Grameno' afër kafenesë 'Shtëpisë së vjetër' është i dëmtuar, në rrugën 'Pajazit Islami', kriteret për vendosjen e policëve të shtrirë nuk janë të njejtë, në dyqind metra gjatësi nuk ka asnjë policë të shtrirë, nga çerdhja deri te varrezat, ndërsa në njëqind metra në një zonë janë katër policë të shtrirë. Kush duhet t'i mbjellë pemët dekorative, sigurisht që Kompania që e fiton tenderin, duhet ta kryen punën e saj.

Migjen Kolshi: Është hapur aty një furrë e re në fshatin Miradi e Poshtme, por ju i nderuari anëtarë i Kuvendit të Komunës z. Sabit Bullatovci nuk jeni i njëjtë për të gjithë në qëndrimet tuaja të shprehura publikisht. Më herët edhe anëtari i Kuvendit të Komunës z. Shaban Ademi, e ka ngritur problemin e kafenesë me muzikë të gjallë në pronën publike, që i dëmton edhe qytetarët, e ju nuk po e përmendëni fare këtë objekt.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Me ndriçimin publik po kemi telashe me një Kompani të pa përgjegjshme, ata i kam telefonuar disa herë, por nuk po kemi llogari, as ta shkëpusim kontratën. Disa prishje do t'i rregullojmë nesër, sepse unë sot e kam patur një takim me përfaqësuesit e Kompanisë. Në fshatin Harilaç ka patur problem me pagesën e borxheve, kjo punë do të rregullohet tani. Lidhur me problemin me ujërat e zeza në fshatin Henc jemi të njoftuar, ka telashe të cilat duhet të sanohen nga Kompania e Ujësjellësit Rajonal 'Prishtina', edhe ne e kemi një Kompani të kontraktuar për mirëmbajtjen e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimeve, por nëse i hymë ndryshimeve, na marrin dy muaj, sepse Organi Shqyrtues i Prokurimit vepron shumë ngadalë në shqyrtimin e ankesave, problemet mbesin tek ne në sezonin e dimrit. Mbjellja e pemëve dekorative është bërë 99% nga Kompania, disa janë mbjellë nga punëtorët e pastrimit, ato nuk janë molla, por një lloj i pemëve dekorative. Shqetësimi i ngritur nga anëtarët e Kuvendit të Komunës z. Mehdi Lahu dhe Naser Graiçevci, interevenimet në rrugë në qytet ndodhin çdo ditë, ne japim pëlqime ndonjëherë por kërkojmë që të riparohen rrugët pas kryerjes së punimeve. Unë në parim jam kundër dhënies së pëlqimeve për vendosjen e policëve të shtrirë, në fshatin Lismir janë vendosur katër police të shtrirë në rrugë, të cilët janë hequr nga vetë banorët. Sa i përket qenëve endacak në rrugën 'Imer Svarqa' dhe zonën për rreth aty, ne do të rregullojmë ndriçimin gjatë ditëve në vijim. Për trajtimin e qenëve endacak ne e kemi një Kompani të kontraktuar, por ka edhe njerëz që po i ushqejnë qentë dhe nuk lejojnë që ne t'i trajtojmë.

Eglantina Azemi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, kur do të furnizohet me ujë të pishëm fshati Bardh i Madh, sepse atje ka furnizim me ujë vetëm një orë në ditë.

Nënkryetari i Komunës: Jemi në bisedime me Kompaninë e Ujësjellësit Rajonal 'Prishtina', në muajin mars apo prill të vitit të ardhshëm do të fillojnë punimet.

Pika e tretë (3) - Propozim për fillimin e procedurave për lejimin e ndërtimit të objektit shkollorë në Fushë-Kosovë me kompensim në ndërtim.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, 'Propozimin për fillimin e procedurave për lejimin e ndërtimit të objektit shkollorë në Fushë-Kosovë me kompensim në ndërtim', duke marrë parasysh dy rekomandimet e dalura nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa. Ndërtimi i shkollës në atë pjesë të qytetit tonë është i nevojshëm, për arsye të migrimit të popullsisë nga vise të ndryshme të Kosovës dhe rritjes së numrit të nxënësve për çdo vit. Kompensimi për Kompaninë 'Al Trade', do të bëhet në ndërtim me etazhitet P+7, vetëm për 50% të hapësirës së lejuar të sipërfaqës prej 1500m² të pronës për shkollën. Ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban që të na jap sqarime.

Drejtori për Planifikim Urban: Para vetës e keni një propozim të Kryetarit të Komunës për të cilin kërkohet të merret një vendim politikë. Unë e kam sqaruar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa kërkesa e Kompanisë 'Al Trade' bien poshtë dhe kalkulimet e bëra aty nuk vlejnë. Në takim me Kryetarin e Komunës dhe përfaqësuesin e Kompanisë 'Al Trade', unë e kam sqaruar se ne mund të bëjmë kompensimin në ndërtim për 15 ari tokë që ndahen për shkollën, vetëm deri në 50% të sipërfaqës sipas Planit Zhvillimor të mëparshëm, por jo edhe për pronat tjera të evidentuara në materialin që ju e keni marrë për shqyrtim. Elementi i dytë ju para vetës e keni kërkesën e ndërtuesit, vendimi për ndërtim në atë zonë mund të shkon vetëm deri në P+7 dhe 40% e sipërfaqës, në P+8 mund ta lejohet nga ju vetëm kompensimi për shkollë. Në muajin janar pritet ta miratojmë edhe Hartën Zonale të Komunës, që do t'i definon edhe koeficientët e ndërtimit për territorin e komunës. Sipas vendimit ndërtimi është deri në 40% të sipërfaqës me koeficientin 3.2. Bonuset e ndërtimit do të caktohen nga ekspertët e fushës së ndërtimit dhe planifikimit urban.

Migjen Kolshi: Atëherë pse një propozim i tillë pa sqarime, është dërguar për aprovim në Kuvendin e Komunës.

Drejtori për Planifikim Urban: Unë e theksova, ju e keni një propozim të Kryetarit të Komunës dhe duhet ta merrni një vendim si Kuvend i Komunës.

Durim Hajra: Ne Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje në parim jemi për ndërtimin e shkollës, sepse është një nevojë për komunën tonë. Pse nuk po presim edhe një muaj deri në miratimin e Hartës Zonale të Komunës dhe ta kemi një process të rregulltë për të gjitha çështjet. Kompensimi duhet të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me Hartën Zonale të Komunës, e jo në bazë të kriterëve tjera, apo kriterëve të caktuar nga Kompania 'Al Trade'. Me Planin Zhvillimor Komunal, Planin Zhvillimor Urban dhe Planet Rregulluese Urban ndërtimi në atë zonë është P+1 apo P+7, unë vendimin e vitit 2016 e kërkova në ueb-faqe, por nuk e gjeta askund. Elementi tjetër me rëndësi, a janë konsultuar banorët e asaj zonë për ndërtimin e shkollës në lagjen e tyre. Unë e di që maksimumi i koeficientëve të ndërtimit sipas Hartës Zonale të Komunës është 2.4, e jo 3.2, andaj kërkojmë sqarime.

Drejtori për Planifikim Urban: Jo po flitni skarazi, këtu duhet ta merrni një vendim politikë, që është i nevojshëm për ndërtimin e shkollës, kompensimi bëhet përmes marrëveshjes, ku detajet teknike definohen nga ekspertët e fushës së ndërtimit. Këtu kompensimi bëhet për 50%, për 750m², me etazhitet P+7, këtu kompensimi nuk bëhet sipas Hartës Zonale të Komunës, e cila nuk është miratuar ende në Kuvendin e Komunës.

Durim Hajra: Shkurt, ne nuk po e shohim marrëveshjen për kompensim që mund ta arrin maksimumin në 3.2, marrëveshjen do ta lidh Kryetari i Komunës. Unë në fillim dëshirova të jem parimorë, por pa definim të qartë nuk mund ta votojmë propozimin në fjalë.

Drejtori për Planifikim Urban: Ju para vetës e keni një document politikë, unë nuk kam qenë në takim me përfaqësuesit e partive politike në Zyrën e Kryetarit të Komunës, me përfaqësuesit e Kompanisë 'Al Trade'. Kompania i jep 15 ari tokë, që duhet të kompensohen në ndërtim, ai pronë falë nuk jep.

Remzi Shala: Në takimin e mbajtur në Zyrën e Kryetarit të Komunës, në biseda ne e kemi dhënë pëlqimin dhe qëndrimin tonë se ndërtimi i shkollës është i nevojshëm, tani ne e kemi lokacionin e propozuar për ndërtimin e shkollës dhe rekomandimin e dalur nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa, që kompensimi në ndërtim të bëhet 50%, për sipërfaqën e lejuar për ndërtimin e shkollës, ne jemi për aprovimin e dy rekomandimeve të Komitetit për Politikë e Financa.

Mehdi Lahu: Në materialin e dorëzuar për shqyrtim e kemi ofertën e Kompanisë 'Al Trade', unë e kam lexuar materialin e dorëzuar aq sa kam mundur dhe sa kam ditur, aty kam vërejtur se Komuna e Fushë-Kosovës, po i bënë një lëshim shumë të madh Kompanisë për ndërtimin e shkollës. Duhet ta presim miratimin e Hartës Zonale të Komunës dhe t'i caktojmë bonuset e ndërtimit sipas saj, atëherë na vjen edhe marrëveshja, unë jam për caktimin e bonuseve të arsyeshme. Shkolla, bonuset nga ofertuesi janë llogaritur me koeficientin katër, oferta është bërë me 50%, ku fitimi i Kompanisë në dëm të komunës është 160.000m².

Nënkryetari i Komunës: Nuk duhet të bëni propagandë palidhje, përmes insajderit që Kryetari i Komunës z. Burim Berisha dhe biznesi, sepse aim und t'iu paditë juve dhe insajderin. Ai ka hyrë në një punë për arsye se ne jemi peng i proceseve të mbrapshta, që na kanë shkaktuar shumë dëm neve dhe investuesit atje, sepse ju po merreni me dezinformata, duhet të jeni të kujdesshëm me investitorët. Në rastin konkret investitori ka ofruar 15 ari tokë, që në fakt është pronë e qytetarëve atje e dhënë për ndërtim.

Mehdi Lahu: Unë nuk kam bërë asnjë dezinformatë, ofertën e ofertuesit e kam mbledhur, aty i keni katër blloqer B1, B2, B3 dhe B4, kur mbledhen ato del përqindja e ndërtimit, e përcaktuar me koeficientin katër janë 90.000m². Lokacioni i saktë i shkollës do të jetë, te rruga e Uglarit, por ngastrat kadastrale të ofruara në material për ndërtim vijnë deri te ndërmarrja 'Boshi'. Vendi adekuat për ndërtimin e shkollës do të ishte paralelë me shkollën 'Mihal Grameno', por nëse i hymë kësaj pune duhet të kompensohen edhe investitorët tjerë. A është ajo zonë për ndërtime të larta sipas Planit Rregullativ, pse nuk po e presim Hartën Zonale të Komunës për një muaj sipas të cilës koeficienti i ndërtimit mund të shkon deri në 3.2. situata tani është e pa qartë, unë jam kundër marrëveshjes e cila nuk është e qartë. Atë që e kam thënë te insajderi qëndron, sepse unë e kam thënë vetëm ofertën e ofertuesit.

Nënkryetari i Komunës: Ju nuk po e thuani të vërtetën kur theksoni se këtu kompensimi shkon në 160.000m², për 15 ari tokë që merren për shkollën, do të kompensohen me 50% ndërtim.

Mehdi Lahu: Atëherë duhet ta bëni një formulim ndryshe të propozimit për ndërtimin e shkollës.

Driton Ademi: Ju e dini vendimin tim unë jam kundër, qëndrimin tim e them këtu, meqë kemi të bëjmë me institucionin, jo me një person fizik dhe juridik që e ndërron tokën. Kryetari dhe Kryesuesja e hartojnë rendin e ditës dhe e kanë dërguar pikën për shqyrtim në Kuvendin e Komunës. Zyra për Informim e Kryetarit të Komunës e ka publikuar një komunikatë për takimin me përfaqësuesit e subjekteve politike të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës, ju nuk duhet të manipuloni me emrin e të gjithëve, unë nuk kam qenë i ftuar në atë takim për shkollën, mos dezinformoni. Unë e di ju e keni Komitetin për Politikë e Financa jo legjitim, andaj duhet të gjeni forma tjera të komunikimit dhe vendimarrjes, ju lutem mos e keqinformoni publikun, sepse Nisma Socialdemokrate nuk ka patur ftesë për takim. Mundësinë në Kuvendin e Komunës e kemi që t'i

shprehim qëndrimet tona, këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me pjesën të Uglari, por edhe me ngastra tjera kadastrale në Fushë-Kosovë. Disa ngastra kadastrale aty janë në zonën neutrale në mes të Uglarit dhe Fushë-Kosovës për të cilat ne nuk kemi kompetencë, andaj mos e manipuloni opinionin në emër të të gjithëve.

Nënkryetari i Komunës: Takimi ka qenë me partitë politike me numrin më të madh të anëtarëve në Kuvendin e Komunës, të cilët kanë biseduar për çështjen në fjalë.

Driton Ademi: Partia Aleanca Kosova e Re, është partia e madhe në Kuvendin e Komunës.

Nënkryetari i Komunës: Aty kanë qenë të pranishme Partia e Drejtësisë dhe Aleanca Kosova e Re.

Aida Alimi: Më pengon fakti, që neve po diskutojmë këtu pa sqarime, pa asnjë takim informues për asnjë punë në terren. Këtu nuk e kemi qëndrimin e Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të Kompanisë 'Al Trade', sepse këtu kemi të bëjmë me një pjesë të pronave afër Graq-anicës, ne e kemi një vendim për ndërtim 40%, me 60% dhe këtu nuk e kemi asnjë marrëveshje. Dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa e kemi patur një ecje procedurale, aty duhet ta kemi ridestinimin e zonës, sepse aty kemi banim individual. Kryesuesja e Kuvendit të Komunës tha se kompensimi duhet të bëhet për 15 ari tokë, ndërsa në propozim shkruan se aty janë 15-25 ari tokë. Ne duhet ta kemi një informim të drejtë për 15 ari tokë, sipërfaqja duhet të jetë e saktë.

Sabit Bullatovci: Këtu duhet të jetë prezentë Drejtori i Planifikimit Urban të na tregojë saktë ku do të ndërtohet shkolla, mirë këtu është Nënkryetari i Komunës, shkolla do të jetë në zonën e Fushë-Kosovës në qoshe, atje jepen 1500m², në pjesën e pa ndërtueme atje, por atje ka objekte kolektive të banimit P+8, atje janë edhe pesë objekte tjera të banimit, ne vetëm po i bëjmë beneficione atij, një etazhë e banimit atje bënë 5000m².

Nënkryetari i Komunës: Kuvendi duhet ta bjen një vendim të drejtë, kuptojeni me 50% kompensim në ndërtim për sipërfaqen e shkollës.

Sabit Bullatovci: Për ato metra katërorë investitori nuk hyn në bashkëpunim me komunën, por ai kërkon ndërtim edhe në lokacione tjera deri në Bresje. Harta Zonale e Komunës vjen aty ndërtimi duhet të bëhet sipas hartës, pse nuk vjen Kryetari i Komunës të na sqaron neve.

Nënkryetari i Komunës: Aty do të bëhet ndërtimi i objektit shkollorë në sipërfaqe prej 1500m².

Sabit Bullatovci: I nderuari Nënkryetar i Komunës ju nuk po kuptoni qartë zonën ku duhet të ndërtohet shkolla dhe lokacionin për kompensim.

Migjen Kolshi: Në këtë fushë ka shumë probleme, shumica e ndërtimeve, gati të gjitha janë në 80% të sipërfaqes. Ne në parim jemi për ndërtimin e shkollës, tani Drejtori për Planifikim Urban e theksoi se për 1500m², që jepen për ndërtimin e shkollës do të kompensohen në ndërtim 50%. Unë jam që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një javë, nëse është gati Harta Zonale e Komunës të punojmë sipas saj në përcaktimin e bonuseve të ndërtimit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Ju duhet ta shikoni mirë rendin e ditës, vendimet do të merren duke u mbështetur në dy rekomendimet e Komitetit për Politikë e Financa, duhet të shpallet interesi i veçantë për sipërfaqen që caktohet për ndërtimin e shkollës, Kompania 'Al Trade' kompensohet me 50% në ndërtim, për sipërfaqen e dhënë për ndërtimin e shkollës.

Shaban Ademi: Unë jam për aprovimin e dy rekomandimeve të Komitetit për Politikë e Financa, sepse vendime të tilla kemi marrë edhe në të kaluarën, ju si anëtarë të Kuvendit të Komunës nuk keni asnjë dëm nga kjo, nëse diçka është e paligjshme është Ekzekutivi i Komunës përgjegjës që të mos e zbaton. Ne nuk kemi përgjegjësi penale për këtë punë, vetëm mund të na brenë ndërgjegjëja, por kur shkolla është në pyetje unë jam për.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës qiti në votim 'Propozimin që rekomandimi për shpalljen me interes të veçantë të lokacionit të prpozuar në sipërfaqe prej 1500m², të caktuara nga pronat e Kompanisë 'Al Trade', për ndërtimin e shkollës në këtë zonë të Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', dy 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej nëntëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin që rekomandimi për shpalljen me interes të veçantë të lokacionit të prpozuar në sipërfaqe prej 1500m², të caktuara nga pronat e Kompanisë 'Al Trade', për ndërtimin e shkollës në këtë zonë të Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 1823, të datës 26.11.2019 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit shkollor në anën e djathtë të rrugës Fushë-Kosovë/Prishtinë, pjesë e Ngastrave Kadastrale: Nr. P-72514036-01037-293, P-72514036-01037-71, P-72514036-01037-93, P-72514036-01037-06, P-72514036-01037-141, në Zonën kadastrale Fushë-Kosovë, në sipërfaqe të ndarë prej S=1500m² dhe shpalljen me interes të veçantë të pronës private të dhënë nga Kompania 'Al Trade', Komunës së Fushë-Kosovës, me destinim për ndërtimin e shkollës.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës qiti në votim 'Propozimin që rekomandimi për ndërtimin e shkollës do të jetë në atë zone me etazhitet P+7, ku kompensimi në ndërtim për sipërfaqen e shkollës prej 1500m², do të bëhet në tri objekte të Kompanisë 'Al Trade', do të jetë 50%, kjo punë do të realizohet nga ekspertët e fushës së ndërtimit'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', katër 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej nëntëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin që rekomandimi për ndërtimin e shkollës do të jetë në atë zone me etazhitet P+7, ku kompensimi në ndërtim për sipërfaqen e shkollës prej 1500m², do të bëhet në tri objekte të Kompanisë 'Al Trade', do të jetë 50%, kjo punë do të realizohet nga ekspertët e fushës së ndërtimit' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 1823, të datës 26.11.2019 për fillimin e procedurave për lejimin e ndërtimit të objektit shkollor në anën e djathtë të rrugës Fushë-Kosovë/Prishtinë, në Ngastrat Kadastrale: Nr. P-72514036-01037-293, P-72514036-01037-71, P-72514036-01037-93, P-72514036-01037-06, P-72514036-01037-141 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, të ndarë në sipërfaqe prej S=1500m², duke e kompensuar Kompaninë 'Al Trade', me etazhitet P+7 përmes bonuseve në ndërtim në tri objekte të kompanisë deri në 50% të sipërfaqes së përgjithshme S=1500m², të dhënë për shkollën, përmes caktimit të kushteve ndërtimore dhe lejeve për ndërtime nga ekspertët e fushës së ndërtimit të Komunës së Fushë-Kosovës dhe Kompanisë 'Al Trade', në zonën afër shkollës.

Koha e pushimiit prej 15 minutave.

Pika e katërt (4) - Propozim për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e marrëveshjes për kompensim të pronarëve në fshatin Sllatinë e Madhe.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e marrëveshjes për kompensim e tre pronarëve në fshatin Sllatinë e Madhe', për arsye të realizimit të projektit të infrastrukturës, asfaltimit të rrugës të pishat, ftoi përfaqësuesin e Ekzekutivit të Komunës që të na jap sqarime.

Nënkryetari i Komunës: Në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa ne realisht e kemi pranuar se nuk është dashur të shkojmë në këtë mënyrë, por e kemi filluar asfaltimin e rrugës me mirëbesim, ku Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka financuar me 80% të mjeteve financiare, ndërsa komuna me 20%, ky asfaltim ka prekur pronat e katër qytetarëve, tre prej tyre janë pajtuar me vlerësimin, njëri jo, ai ka vendosur që të shkon përmes procedurave gjyqësore. Vlerësimi është bërë nga vlerësuesi i licensuar, ky një metër katërorë e ka vlerësuar 30.40€, ndërsa një ari 3,000.00€.

Mehdi Lahu: Kjo punë nuk ka qenë urgjente, është dashur që së pari të zhvillohen procedurat e shpronësimit të pronave, pastaj të realizohet projekti publik. Është gabim që së pari është kryerë puna, kjo është humbje për qytetarin, ai ka të drejtë të kërkon edhe 5,000.00€ për pronën e tij. Institucioni të punon në mirëbesim është e papranueshme, ne e dimë që qytetarët janë vrarë edhe për pak metra tokë si shqipëtarë, unë jam kundër.

Migjen Kolshi: Në fillim unë jam kundër Komisionit për vlerësimin e pronave, dikun janë 3.50 ari tokë, dikun 4 ari tokë, pagesa për një ari është 3,000.00€. Vlerësuesi i licensuar këtu i'a ka huqur krejtë, është interesi i tyre të përfitojnë, toka e tyre do të jetë precedentë për rastet tjera. Edhe unë e kam shtruar rrugën në lagjen time, sipas kësaj logjike i bjen që kam të drejtë ta padisë komunën dhe të marrë vlerësimin për pronën time. Heqja e asfaltit është e padrejtë, paraqet një nënshtrim për qytetarët, duhet të veprohet sipas procedurave të shpronësimit.

Durim Hajra: Ne edhe në një rrugë sekondare që lidhet me rrugën 'Pajazit Islami', vitin e kaluar e kemi kompensuar një pronarë, andaj ne si Grup Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje jemi kundër, kërkojmë që të ndjekin procedurat e shpronësimit dhe procedurat tjera. Ligji i shpronësimit është shumë i qartë, nëse nuk përfillet, qytetarët kanë të drejtë të padisin komunën, nëse hyn në pronën e tyre. Qytetarët mund të jenë të paknaqur me vlerësimin kanë të drejtë të kërkojnë edhe nga 5,000.00€ për një ari tokë, por ne nuk duhet të veprojmë kështu si institucion dhe të shkaktojmë precedent për rastet tjera.

Remzi Shala: Edhe Nënkryetari i Komunës e ceku se këtu kemi patur të bëjmë me një donacion të Ministrisë, vendi atje të pishat është bërë një vend i mirë për vizitorët, zgjerimi i rrugës te pishat ka qenë i nevojshëm si investim, madje edhe për banorët e fshatit Sllatinë e Vogël, rruga aty ka qenë e ngushtë, kërkesat për kompensimin e tre pronarët janë të arsyeshme dhe duhet të përmbushen, ndërsa Zgjidhja që nuk ka pranuar, të drejtën e tij mund ta realizon përmes procedurës gjyqësore.

Driton Ademi: Cila do të ishte kostoja e shpronësimit, nëse do të respektoheshin procedurat ligjore, ne nuk mund dhe nuk kemi të drejtë të pranojmë marrëveshje të kompensimit, që nuk është në harmoni me ligjin, pa marrë parasysh variantat e vlerësimit, unë jam kundër.

Sabit Bullatovci: Kjo punë po më dhembë në shpirtë, vlerësuesin e njoh, të kushton një arë e klasës së gjashtë 3,000.00€, kjo punë nuk po më hyn në tru hiq, ne jemi njëzet vjet pushtet, është dashur të bëhen matjet gjeodezike para realizimit të projektit, kjo punë hapë rrugë për vlerësime tjera të ngjajshme. Këtu mjete financiare në shumë prej 34,000.00€ janë mjete të taksapaguesëve,

për dy kilometra rrugë, të bëhen kjo punë, rrugët duhet të asfaltohen me standarde, të mos hapim precedent për veprime në të ardhmen, ne i kemi njëmbëdhjetë fshatra ku janë shtruarë rrugë, unë e njoh mirë Zgjimin që i janë marrë 80m², Skenderin 1.34m², duhet t'i lëni këto lojra, përfaqësuesja juridike e komunës çdo ditë ka lëndë, kjo punë nuk është e mirë, nuk duhet të pranohen këto lloje të vlerësimeve, Ekzekutivi i Komunës po luan me Kuvendin e Komunës, së pari duhet të kryehen punët paraprake pastaj të merren paratë nga ministria. U theksua se edhe në fshatrat tjera: Miradi e Poshtme dhe Miradi e Epërme, ku toka është pjellore dhe ka qasje në rrugë të fshatit çmimet janë 1,500.00€ deri në 2,000.00€.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e marrëveshjes për kompensimin e tre pronarëve në fshatin Sllatinë e Madhe'.

U votua me: njëmbëdhjetë vota 'për', tetë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej nëntëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e marrëveshjes për kompensimin e tre pronarëve në fshatin Sllatinë e Madhe' dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e Propozimit Nr.1762, të datës 15.11.2019, për realizimin e "Marrëveshjes për kompensimin e gjashtë paluajtshmërive", në shumë të përgjithshme të mjeteve financiare prej 32,497.60€, për kompensimin e pronave të tre pronarëve privat në fshatin Sllatinë e Madhe të marrura nga Komuna e Fushë-Kosovës, për realizimin e interesit publik, 'Projektit për asfaltimin e rrugës 'Xhamia', për pronarët si vijon:
 - 1.1 Pronari, Naim Enver Nuredini për Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514009-00105-0, me sipërfaqe prej 440m² në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, kompensohet në shumën e mjeteve financiare prej 13,376.00€ dhe për Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514009-00106-0, me sipërfaqe prej 219m² në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, kompensohet me shumën e mjeteve financiare prej 6,657.00€;
 - 1.2 Pronari, Shaban Hamdi Berisha për Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514009-00109-0, me sipërfaqe prej 214m² në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, kompensohet në shumën e mjeteve financiare prej 6,505.50€ dhe për Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514009-00110-0, me sipërfaqe prej 44m² në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, kompensohet në shumën e mjeteve financiare prej 1,337.60€;
 - 1.3 Pronari Skender Mehdi Maliqi për Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514009-00107-0, me sipërfaqe prej 122m² në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, kompensohet në shumën e mjeteve financiare prej 3,708.80€ dhe për Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514009-00113-0, me sipërfaqe prej 30m² në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, kompensohet në shumën e mjeteve financiare prej 912.00€.
2. Shuma e mjeteve financiare të cekur në pikën një të vendimit, paragrafi 1.1, paragrafi 1.2 dhe paragrafi 1.3, është llogaritur në bazë të ekspertizës së vlerësuesit të licencuar Sh.p.k "Box Property", për një metër katrorë është në shumë prej 30.40€ / ndërsa për një një ari është në shumë prej 3,040.00€ dhe konfirmohet me procesverbalin Nr. 1439, të datës 01.10.2019, procesverbalin Nr. 53, të datës 03.10.2019 dhe procesverbalin Nr. 58, të datës 15.11.2019, për marrëveshjet e kompensimit ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës dhe pronarëve: Naim Nuredini, Shaban Berisha dhe Skender Maliqi.

Pika e pestë (5) - Propozim për shqyrtimin e Planit Komunal të Veprimit për personat e Riatdhesuar 2019-2022.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozim për miratimin e Projekt-Planit Komunal të Veprimit për personat e Riatdhesuar 2019-2022', ftoi përfaqësuesin e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale që të na jap sqarime.

Hysen Sllamniku - Zyrtar për Mirëqenie Sociale: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Plani Komunal i Veprimit për Personat e Riatdhesuar 2019-2022, është haruar nga Grupi Punues me përfaqësues nga Drejtoritë e Komunës, mbështetur në 'Strategjinë shtetërore për personat e riatdhesuar', plani ndërlidhet me 'Marrëveshjen e Stabilizim / Asocimit' dhe procesin e liberalizimit të vizave, nuk ka implikime buxhetore për Komunën e Fushë-Kosovës, përmbanë aktivitete zyrtare që ne jemi duke i kryerë për nëntë vite duke filluar nga viti 2010, në bashkëpunimin horizontal mes Drejtorateve të Komunës dhe vertikal me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Unë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa e kam sqaruar dhe jam ndalur te objektivi numër 2, nga pika 2.2 deri te pika 2.8, kujdesi për personat e cënueshëm dhe pa përkujdesje, problem është këtu se ne nuk kemi pronë komunale, por këto objektiva duhet t'i realizojmë në bashkëpunim me komunat e regjionit tonë përmes participimit.

Drejtoresha e Administratës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ky plan i veprimit rrjedh nga obligimet tona për përmbushjen e 'Marrëveshjes së Stabilizim / Asocimit', komuna duhet ta miraton, ndërsa fondet për zbatim janë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përgjegjëse për trajtimin e personave të riatdhesuar në komunë, është Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Driton Ademi: Kjo pikë e rendit të ditës vlenë të diskutohet, sepse është q-ështje institucionale dhe ndër sektoriale në kuptimin horizontal të veprimit në Komunën e Fushë-Kosovës. Objektivat dhe aktivitetet e prezantuara në këtë plan të veprimit janë afër optimumit dhe ne si subjekt politikë Nisma Socialdemokrate jemi për, por kërkojmë që ta kemi një raport periodikë për punën në shërbime të veçanta. Këtu ka punë që lidhen me tregun e punës, planin e biznesit, subvencionimin e personave të riatdhesuar për riintegrim në shoqëri. Planit i mungon kostoja financiare, por ne jemi parimisht për aprovimin e tij dhe realizimin e objektivave.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për diskutim publik, 'Planin Komunal të Veprimit për Personat e Riatdhesuar 2019-2022'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej nëntëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi në parim për diskutim publik 'Planin Komunal të Veprimit për Personat e Riatdhesuar 2019-2022' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim, të Planit Komunal të Veprimit për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar 2019-2022 në Komunën e Fushë-Kosovës dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për caktimin e Komisioneve për përzgjedhjen e krijuesit dhe sportistëve për vitin 2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për caktimin e dy Komisioneve për krijuesin dhe sportistët e vitit 2019', në përbërje secili me nga shtatë anëtarë, nga

katër prej tyre nga Kuvendi i Komunës, dy nga Ekzekutivi - Administrata e Komunës dhe nga një prej Shoqërisë Civile. Hap diskutimin për propozimet e juaja.

Remzi Shala: Ne besojmë që Komisionet do të punojnë në bazë të kriterëve, në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për anëtar të Komisionit për krijuesin e vitit e propozojmë z. Ilir Hasani, ndërsa për anëtare të Komisionit për sportistët e vitit e propozojmë znj. Arjeta Jashari.

Eglantina Azemi: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për anëtare të Komisionit për krijuesin e vitit e propozojmë znj. Doruntina Jashari, ndërsa për anëtar të Komisionit për sportistët e vitit e propozojmë z. Durim Hajra.

Aida Alimi: Nga Partia Demokratike e Kosovës në Komisionin për krijuesin e vitit do të jem unë, ndërsa për anëtare të Komisionit për sportistët e vitit e propozojmë znj. Arjana Zogjani.

Migjen Kolshi: Dua të sqaroj se unë këtë vit nuk do të jem në Komisionin për përzgjedhjen e sportistëve të vitit 2019.

Nënkryetari i Komunës: Unë për anëtarë në Komisionin për sportistët e vitit e propozoi z. Mehdi Lahu, ndërsa në Komisionin për krijuesin e vitit e propozoi z. Ali Ismaili. Ndërsa nga Ekzekutivi - Administrata e Komunës në Komisionin për krijuesin e vitit i propozojmë z. Islam Shabani dhe z. Ali Topalli, kurse në Komisionin për sportistët e vitit i propozojmë z. Ekrem Berjani dhe z. Fatlum Berisha.

Pas diskutimeve, për anëtarë të Komisionit për përzgjedhjen e sportistëve të vitit nga Shoqëria Civile u propozua z. Maliq Thaçi, ndërsa për Komisionin për krijuesin e vitit u propozua z. Emin Emini.

Pas dhënies së propozimeve për dy Komisionet, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës i qiti në votim në paketë, 'Propozimin që anëtarë të Komisionit për përzgjedhjen e krijuesit të vitit 2019', të jenë: Ilir Hasani, Doruntina Jashari, Aida Alimi, Ali Ismaili, Islam Shabani, Ali Topalli dhe Emin Emini', ndërsa në 'Propozimin për anëtarë të Komisionit për sportistët e vitit 2019', të jenë: Arjeta Jashari, Durim Hajra, Arjana Zogjani, mehdi Lahu, Ekrem Berjani, Fatlum Berisha dhe Maliq Thaçi.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithësej nëntëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave i aprovoi 'Propozimet për caktimin e anëtarëve të Komisionit për përzgjedhjen e krijuesit të vitit 2019 dhe Komisionit për përzgjedhjen e sportistëve të vitit 2019 në përberjet e cekura më lartë' dhe mori këto:

V E N D I M

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Krijuesit të vitit 2019', në përberje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 1.1 Ilir Hasani - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.2 Doruntina Jashari - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.3 Aida Alimi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.4 Ali Ismaili - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.5 Islam Shabani - Drejtor i Arsimit, anëtar;
 - 1.6 Ali Topalli - Zyrtar për Informim, anëtar;
 - 1.7 Emin Emini - Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të suksesshëm në konkursin për 'Krijuesin e vitit 2019'.

V E N D I M

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Sportistëve të vitit 2019', në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve:
 - 1.1 Arjeta Jashari - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.2 Durim Hajra - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.3 Arjana Zogjani - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.4 Mehdi Lahu - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.5 Ekrem Berjani – Drejtor për Zhvillim Ekonomik, anëtar;
 - 1.6 Fatlum Berisha - Zyrtar për Sport, anëtar;
 - 1.7 Maliq Thaçi - Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të suksesshëm në konkursin për 'Sportistët e vitit 2019'.

Pika e shtatë (7) – Propozim për lejimin e mjeteve financiare për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti në Shqipëri.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozim për lejimin e mjeteve financiare për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor në Shqipëri'. Po ashtu dua të i'u njoftoj se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka propozuar që ta mbajmë një mbledhje më herët, por meqë ishte e caktuar mbledhja e rregulltë, nuk ka patur nevojë të thirret mbledhje e jashtëzakonshme. Hap diskutimin.

Nënkryetari i Komunës: Komuna e Fushë-Kosovës, propozon që të ndahet shuma e mjeteve financiare prej 10,000.00€, ndërsa nga kjo shumë propozon që të ndahen 5,000.00€ për familjet e vëllezërve Abazi nga Komuna e Gjilanit dhe shuma tjetër prej 5,000.00€ për të ndihmuar familjet tjera në nevojë në zonat e prekura nga fatëkeqësia natyrore në Shqipëri.

Aida Alimi: Unë propozoi që për familjet e prekura nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor në Shqipëri, të ndahet shuma e mjeteve financiare prej 10,000.00€, ndërsa për familjet e vëllezërve Abazi nga Komuna e Gjilanit shuma e mjeteve financiare prej 5,000.00€.

Durim Hajra: Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka ofruar ndihmë për të prekurit nga tërmeti në Shqipëri në fillim, madje ka strehuar edhe disa familje në Fushë-Kosovë. Ne kërkojmë që mjetet e ndara financiare të përdoren edhe për të strehuarit në Kosovë dhe për këtë ta bashkëpunojmë me Komisionin për ndihma emergjente në kuadër të komunës.

Migjen Kolshi: Unë mendoi se ku reagim i yni është i vonshëm, në kohën e luftës së Kosovës të vitit 1998-1999, në Shqipëri jemi strehuar pjesa më e madhe e popullatës së Kosovës, në kohën më të vështirë për ne dhe jemi mirëpritur, andaj unë pajtohem me propozimin e znj. Aida Alimi, që për të ndihmuar të prekurit nga tërmeti i datës 26 nëntor në Shqipëri, të ndahet shuma e mjeteve financiare prej 10,000.00€. ka patur edhe aspekte politike këtu dhe keqinformim nga rrymatë ndryshme, duke i gënjyerë njerëzit se do të shkojnë edhe në Gjermani.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Sqaroi se nuk është thirrur mbledhja e jashtëzakonshme, për arsye se atë ditë, ne e kemi thirrur mbledhjen e rregulltë të Kuvendit të Komunës.

Remzi Shala: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e vlerëson ndihmën si vlerë shumë të madhe, ndërsa shuma mund të jetë edhe simbolike. Pajtohem me mendimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës që të kemi një kujdes për personat e strehuar në Komunën e Fushë-Kosovës.

Mehdi Lahu: Unë propozoi që shuma prej 10,000.00€, të ndahet 8,000.00€ për të ndihmuar të prekurit nga tërmeti i 26 nëntorit në Shqipëri, ndërsa shuma prej 2,000.00€ për familjet e vëllezërve Abazi nga Komuna e Gjilanit.

Nënkryetari i Komunës: Ne do ta ndërtojmë edhe një shtëpi atje, por tani buxheti është i mbyllur dhe nuk mund të veprojmë.

Sabit Bullatovci: Në vitin 1999 qytetarët e Kosovës kanë qenë të strehuar në Shqipëri, buxheti hapet pas dy muajve dhe ata mund të ndihmohen.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin Për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 10,000.00€, për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti, me destinimin e mjeteve financiare për shpenzim si vijon: shuma e mjeteve financiare prej 5,000.00€, do të ndahen për familjet e vëllezërve Abazi nga Komuna e Gjilanit, të cilët humbën jetën në Durrës të Shqipërisë nga tërmeti dhe shuma e mjeteve financiare prej 5,000.00€, do të ndahet për familjet e të prekurëve nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019 në Shqipëri'.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për' dy 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin Për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 10,000.00€, për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti, me destinimin e mjeteve financiare për shpenzim si vijon: shuma e mjeteve financiare prej 5,000.00€, do të ndahen për familjet e vëllezërve Abazi nga Komuna e Gjilanit, të cilët humbën jetën në Durrës të Shqipërisë nga tërmeti dhe shuma e mjeteve financiare prej 5,000.00€, do të ndahet për familjet e të prekurëve nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019 në Shqipëri' dhe mori:

V E N D I M

1. Për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 10,000.00€, për të ndihmuar të prekurit nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor në Shqipëri, me destinimin e mjeteve financiare për shpenzim si vijon:
 - 1.1 Shuma e mjeteve financiare prej 5,000.00€, do të ndahen për familjet e vëllezërve Abazi nga Komuna e Gjilanit, të cilët humbën jetën në Durrës të Shqipërisë nga tërmeti;
 - 1.2 Shuma e mjeteve financiare prej 5,000.00€, do të ndahet për familjet e të prekurëve nga fatëkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor 2019 në Shqipëri.

Pika e tetë (8) - Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Ilir Hasani: Kur do të bëhet blerja e mjeteve elektronike të punës - llaptopëve për anëtarët e Kuvendit të Komunës.


Nënkryetari i Komunës: Kjo procedurë është penguar të realizohet nga niveli qendrorë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:40 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

